



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 6336 / Prot.

Tiranë, më 22.12.2023

Lënda: Kthim përgjigje

ZNJ. SIDORELA DRIÇI
Instituti Shqiptar i Shkencave
Adresa: Rruga "Asim Vokshi", Pallati nr. 13/25, Kati 3

TIRANË

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e organizatës në të cilën ushtroni profesionin, në përgjigje të kërkesës tuaj regjistruar me numër rendor 37, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 6336 Prot., datë 11.12.2023, referuar ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, si dhe në bazë të të dhënave që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore, dosja personale e gjyqtarëve, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Znj. Arnisa Këlliçi ka kryer studimet e larta pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitet akademike 2002-2006.

Në vitet 2006-2007 ka kryer ciklin e dytë të studimeve në programin "Master në Shkenca Juridike në të Drejtë Ndërkombëtare Biznesi" pranë Universitetit të Europës Qendrore, Budapest, Hungari dhe në vitin 2011 ka përfunduar Doktoraturën në Shkenca Juridike, Universiteti i Europës Qendrore, Budapest, Hungari profili "E Drejtë Ndërkombëtare Tregtare".

Në vitet 2018-2020 ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës, Tiranë, duke fituar titullin "Magjistrat", në profilin "Gjyqtar", me vlerësimin Shumë Mirë.

Me anë të vendimit nr. 475, datë 20.10.2020, të Këshillit të Lartë të Gjyqësor, znj. Arnisa Këlliçi është emëruar gjyqtare.

Këshilli i Lartë i Gjyqësor, me vendimin nr. 516, datë 27.10.2020, ka vendosur që gjyqtarja e emëruar znj. Arnisa Këlliçi të caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Në datën 12.07.2021, Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, ka vendosur të komandojë gjyqtaren znj. Arnisa Këlliçi si Zëvendës-Kryetare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në datën 06.09.2022 dhe në vijim ka ushtruar funksionin si gjyqtare pranë kësaj gjykate.

Me vendim nr. 137, datë 28.03.2023 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së

Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Tiranë", nga data 01.05.2023 gjyqtarja znj. Arnisa Këlliçi është transferuar në pozicionin e përhershëm si gjyqtare pranë kësaj gjykate, ku dhe aktualisht ushtron detyrën.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj gjyqësore, për gjyqtaren znj. Arnida Këlliçi nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Bashkëlidhur lutemi gjeni CV-në e znj. Arnisa Këlliçi, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksion të Përgjithshëm Tiranë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

RUDIN RAQLI



CURRICULUM VITAE
ARNISA KËLLIÇI (GOREZI)

Adresa:

Tel:

Email:

EDUKIMI DHE KUALIFIKIMI

- 2007 - 2011** **Doktoraturë në Shkenca Juridike (S.J.D.),**
Universiteti i Europës Qendrore, (Central European
University), Budapest, Hungari.
Profili: E Drejtë Ndërkombëtare Tregtare.
Disertacioni i vlerësuar maksimalisht *Summa Cum
Laude*.
- Shtator - Dhjetor 2009** **Studiuese Shkencore e Jashtme (Visiting Scholar)** në
Qeverisje Korporatash, Universiteti i Kalifornisë
Berkeley, (University of California Berkeley), SHBA.
- 2006 - 2007** **Master në Shkenca Juridike (LL.M.)** në të Drejtë
Ndërkombëtare Biznesi, Universiteti i Europës
Qendrore, (Central European University), Budapest,
Hungari.
- 2002 - 2006** **Diplomë Jurist,** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i
Drejtësisë, diplomuar me **Medalje të Artë.**

EKSPERIENCË PUNE:

Punësim me kohë të plotë:

- 09/02/2017 – aktualisht** **Këshilltare për Shtetin e së Drejtës,** Ambasada e
Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri.
- 03/02/2014 – 07/02/2017** **Këshilltare Ligjore,** Gjykata e Lartë e Republikës së
Shqipërisë.

23/12/2013 – 03/02/2014

Shefe e Sektorit të Integritit Europian, Ministria e Financave.

01/10/2011 – 15/07/2013

Pedagoge me kohë të plotë dhe Drejtuese e Programit Doktorat për Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Europian i Tiranës.

Punësim me kohë të pjeshme/ angazhime profesionale:

Tetor 2013 – Shkurt 2017

Pedagoge me kohë të pjeshme në Universitetin e New York-ut në Tiranë.

Prill 2012 – Shtator 2016

Pedagoge me kohë të pjeshme për disa semestra gjatë kësaj periudhe kohore në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Fakulteti Ekonomik, Elbasan.

Gusht 2008 – Qershor 2011

Asistent Pedagoge dhe Kërkuese Shkencore gjatë programit doktorat në Universitetin e Europës Qendrore (Central European University), Budapest, Hungari.

Shtator 2008 – Korrik 2009

Kërkuese Shkencore me kohë të pjeshme në Qendrën për Biznes dhe Shoqëri (Center for Business and Society) në Shkollën e Biznesit të Universitetit të Europës Qendrore (Central European University Business School), Budapest, Hungari.

CMIME DHE BURSA TË FITUARA:

2008 - 2011

Fondi i Ekselencës për Studime Doktorale të kryera jashtë Republikës së Shqipërisë, akorduar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Qershor 2007

Çmimi Lovell në Të Drejtë Ndërkombëtare Biznesi, akorduar nga Zyra Ndërkombëtare Ligjore Lovell në bashkëpunim me Universitetin e Europës Qendrore (Central European University) Budapest, Hungari, për arritje akademike gjatë studimeve master.

Korrik 2006

Medalje e Artë, akorduar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Rektori i Universitetit të Tiranës për rezultate maksimale (Mesatare e notave 10.00 nga 10.00) gjatë studimeve universitare në drejtësi.

BOTIME DHE PREZANTIME TË PËRZGJEDHURA:

Dhjetor 2017

Disa problematika aktuale në të kuptuarit e figurës së veprës penale “Mjekim i Pakujdesshëm” në optikën e së Drejtës Penale të Krahasuar, Këlliçi Arnisa & Demneri Rezarta, Artikull i prezantuar në konferencën ndërkombëtare “E drejta penale përmes traditës dhe sfidave ekzistuese”, organizuar nga Universiteti i Firences, Universiteti i Romës “La Sapienza” dhe Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, Shqipëri.

Mars 2013

Të drejtat e njeriut dhe korporatat, Gorezi A., Cacaj I. & Çunaj N., Artikull i prezantuar në konferencën ndërkombëtare “Shteti, Shoqëria dhe Ligji”, organizuar nga Universiteti Aleksandër Moisiu dhe Universiteti Luarasi, Tiranë, Shqipëri, Mars 2013.

Tetor 2009

Ekzekutimi i kontratave në Republikën e Shqipërisë: Kapërcimi i dilemave në një treg në zhvillim, (Enforcement of Contracts in the Republic of Albania: Overcoming dilemmas in an emerging market), Gorezi Arnisa & Bashari Evgjeni, Kapitull libri botuar në: Messmann Stefan & Tajti Tibor (eds.), *Case Law of Central and Eastern Europe – Enforcement of Contracts*, (Vendimet gjyqësore në Europën Qendrore dhe Lindore – Ekzekutimi i kontratave), European University Press, Bochum, Gjermani.

Dhjetor 2008

Regjimi ligjor i OBT-së: Forcimi i karakterit ligjor të së drejtës ndërkombëtare?, (The WTO Legal Regime: Strengthening the legal character of International Law?), Artikull i prezantuar në konferencën ndërkombëtare të Universitetit Kolegj të Dublinit (UCD), “Legal Processes Beyond the State”, (Proceset ligjore përtej shtetit), Dublin, Irlandë.

Shtator 2007

Çfarë duhet për ta shndërruar shqiponjën në feniks? Një rishikim i skemave piramidale në Shqipëri, (What will it take to turn the Eagle into a Phoenix? A review of the Albanian pyramid schemes), Artikull i prezantuar në konferencën ndërkombëtare “On Law and Economics” (Mbi ligjin dhe ekonominë) Dubrovnik, Kroaci.

AFTËSI TË TJERA:

Gjuhë të huaja:

Anglisht (Shkëlqyeshëm).

Frëngjisht (Mirë).

Italisht (Mirë).

Hollandisht (Niveli fillestar).

Aftësi kompjuterike:

Microsoft Word, Excel, PowerPoint, etj.